



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2019:124745

Datë: 03.01.2020

Numri i dokumentit: 00745646

P.nr.01/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit F.M. nga fsh.M. - Vushtri për shkak të veprës penale, Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II nr.1731/2016 të datës 03.01.2019, në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me datë 27.12.2019, në praninë e Prokurorit të shtetit Sahit Tmava dhe të pandehurit F.M. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 30.12.2019 me datë 03.01.2020 përpiloj, këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F.M. nga i ati R. e ëma F. e gjinisë M. i lindur me dt... në fshatin B. - Mitrovicë me vendbanim në fsh. M. -Vushtri, me numër persona ... ka të kryer katër vjet të shkollës fillore, pensioner, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ne bazë të nenit 363 paragrafi 1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK),

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: Me datën 22.08.2016, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar paluajtshmërinë në pronën e të dëmtuarve M.D. dhe R.D. në sipërfaqe prej 1.04, 74 ari e evidentuar sipas njësisë kadastrale P-70202049-00491-0, zona kadastrale-Vushtri e datës 21.04.2015, e evidentuar në emër të dëmtuarës R.D. këtë paluajtshmëri i pandehuri edhe më tutje e mban të uzurpuar.

- **Me këtë kishte për të kryer veprën penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.**

Pala e dëmtuar udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë, PP.II nr.1731/2016 të datës 03.01.2019, me të cilin ka akuzuar të pandehurin F.M. nga fsh.M. - Vushtrri për shkak të veprës penale, Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së. Në të gjitha seancat e mbajtura nga gjykata lidhur me këtë çështje penale ka munguar i dëmtuari dhe nga raporti i datës 17.11.2019 i Policisë e Kosovës – është konstatuar se i dëmtuari ka vdekur.

Gjykata ka refuzuar aktakuzën pasi që pas administrimit të provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre lidhur me pronën për të cilën akuzohet i pandehuri, ka ardhë në përfundim se, i pandehuri e ka blerë këtë pronë në vitin 1984 së bashku me shtëpinë dhe se për të njëjtën ka pasur edhe kontratë të lidhur edhe në prezencën e dëshmitarëve por gjatë luftës së fundit i është djegur. Më pas në vitin 1986 pronën për të cilën akuzohet ia ka shitur dëshmitarit F. B. i cili ka hy në posedim të saj dhe atë nga viti 1986. Poashtu në bazë të kontratës së datës 08.05.2015 e lidhur te avokati shihet se dëshmitari F.B. të njëjtën pronë ua ka shitur F.A. M.A. dhe N.A. dhe të njëjtit nga ajo kohë janë në posedim. Në rastin konkret është vërtetuar se i pandehuri nga viti 1986 nuk e ka shfrytëzuar ose poseduar këtë pronë.

Rrjedhimisht, gjykata ka ardhur në përfundim se kjo çështje penale ka arritur afatin e parashkrimit absolut në bazë të nenin 107 par 8 të KPRK-së i cili ka përcaktuar se “Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit”. Në rastin konkret afati i parashkrimit relativ për këtë veprë penale është përcaktuar në nenin 106 par 1 pika 1.5 ku është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar “ tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim”.

Meqenëse kjo çështje penale ka arritur afatin e parashkrimit absolut, gjykata konform nenin 363 par 1 pika 1.3 të KPPK-së e lidhur me nenin 107 par 8 të KPRK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në përputhje me nenin 454. par 1 te KPPK, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimet për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është i mbështetur në nenin 463 par 3 të KPPK-së.

Nga ajo që u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.01/19, datë: 03.01.2020

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.

Numri i lëndës: 2019:124745
Datë: 03.01.2020
Numri i dokumentit: 00745646